

TERMAT E REFERENCËS

**PËR HARTIMIN E STUDIMIT TË FIZIBILITETIT DHE PLANIT TË BIZNESIT PËR
ZHVILLIMIN E SEKTORIT TË BLEGTORISË.**

Hyrje

Sektori i Zhvillimit Strategjik të Blegtorisë, si prioritet i sektorit të bujqësisë në Bashkinë Tiranë, synon hartimin e një Studimi Fizibiliteti dhe Plani Biznesi për zhvillimin e sektorit të blegtorisë në 13 Njësitë Administrative Rurale: Petrelë, Farkë, Dajtë, Zall-Bastar, Bërzhitë, Krrabë, Baldushk, Shëngjergj, Vaqarr, Kashar, Pezë, Ndroq dhe Zall-Herr.

Grupi i punës, ngritur sipas Urdhrit Nr. 215, datë 18.02.2026, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9426, datë 06.10.2005 ‘Për Mbarështimin e Blegtorisë’, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9864, datë 28.01.2008 Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKB-së Nr. 100, datë 18.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026–2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”, përcakton këto Terma Reference për realizimin e projektit të sipërcituar.

Këto Terma Reference përcaktojnë përgjegjësitë, detyrat, metodologjinë dhe kualifikimet e kërkuara për Operatorin Ekonomik të kontraktuar.

1. Qëllimi i projektit

Qëllimi i këtij projekti është hartimi i një studimi të plotë fizibiliteti dhe një Plani Biznesi për zhvillimin e sektorit të blegtorisë në 13 Njësitë Administrative Rurale të Bashkisë Tiranë, me fokus në:

- krijimin e një baze të besueshme të dhënash;
- analizimin e eficiencës ekonomike të sektorit;
- identifikimin e potencialeve dhe sfidave;
- orientimin e politikave publike dhe investimeve drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe konkurrues.

2. Situata aktuale

Aktualisht, sektori i blegtorisë në territorin e Bashkisë Tiranë përballlet me disa sfida strukturore:

- mungesë studimesh të detajuara mbi:
 - tipologjinë e fermave;
 - format organizative dhe të menaxhimit;
 - nivelin e produktivitetit dhe efektivitetit ekonomik;
- mungesë të dhënash të konsoliduara statistikore;
- fragmentarizim të fermave dhe investime të kufizuara në teknologji;

- largim të rinjve nga zonat rurale;
- infrastrukturë të pamjaftueshme për përpunim dhe tregtim.

Këta faktorë kufizojnë zhvillimin e sektorit dhe kërkojnë një ndërhyrje të strukturuar përmes një dokumenti strategjik të bazuar në analiza të thelluara.

3. Objektivat specifike

Operatori Ekonomik duhet të realizojë:

- Analizë të detajuar të gjendjes aktuale të sektorit bazuar në të dhëna në terren;
 - Identifikimin e potencialeve dhe kufizimeve për zhvillim sipas njësive administrative;
 - Vlerësimin e kapaciteteve prodhuese dhe infrastrukturës mbështetëse;
 - Hartimin e strategjive konkrete të zhvillimit;
 - Përgatitjen e një Plani Biznesi të detajuar;
 - Identifikimin e burimeve të financimit dhe skemave mbështetëse;
 - Propozimin e masave për përmirësimin e teknologjisë dhe menaxhimit në ferma.
-

4. Fusha e zbatimit

Studimi do të mbulojë 13 Njësitë Administrative Rurale të Bashkisë Tiranë dhe do të përfshijë:

- Ferma blegtorale (të vogla, të mesme dhe të mëdha);
 - Infrastrukturën mbështetëse (rrugë, magazinim, përpunim, tregje);
 - Zinxhirin e prodhimit dhe tregtimit;
 - Aktorët lokalë (fermerë, institucione, grupe interesi);
 - Analizën territoriale dhe mjedisore (kullota, përdorimi i tokës).
-

5. Përshkrimi i detyrave

5.1 Analiza e situatës aktuale

- Mbledhja e të dhënave në terren;
- Evidentimi i fermave, strukturës së tyre, llojeve të kafshëve dhe prodhimit;
- Ndërtimi i një databaze të strukturuar (Excel/GIS);
- Vlerësimi i teknologjisë dhe praktikave aktuale;
- Analiza e infrastrukturës ekzistuese.

5.2 Analiza ekonomike dhe e tregut

- Analiza e kostove dhe përfitimeve;
- Studimi i tregut lokal dhe rajonal;
- Analiza e kërkesës dhe ofertës;
- Analiza e zinxhirit të vlerës (prodhim – përpunim – tregtim).

5.3 Identifikimi i potencialeve dhe sfidave

- Identifikimi i mundësive për investim dhe zgjerim;
- Identifikimi i pengesave ligjore, teknike dhe financiare;
- Analiza SWOT sipas zonave.

5.4 Analiza sociale dhe mjedisore

- Ndikimi në punësim dhe përfshirje të rinjve;
- Analiza e kullotave dhe përdorimit të tokës;
- Vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe menaxhimit të mbetjeve.

5.5 Hartimi i strategjisë së zhvillimit

- Propozimi i ndërhyrjeve konkrete;
- Modele zhvillimi për zona të ndryshme;
- Identifikimi i projekteve prioritare të investimit;
- Integrimi me politikat vendore dhe kombëtare.

5.6 Hartimi i Planit të Biznesit dhe studimit të fizibilitetit

- Model financiar i detajuar;
- Parashikime financiare për 3–5 vite;
- Analiza e fizibilitetit ekonomik.

5.7 Identifikimi i burimeve të financimit

- Fondet publike vendore dhe qendrore;
- Programet e Bashkimit Europian (p.sh. IPARD);
- Donatorë dhe partneritete publike-private (PPP).

5.8 Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve

- Propozimi i programeve të trajnimit për fermerët;
- Rekomandime për asistencë teknike;
- Ngritja e kapaciteteve institucionale.

6. Raportimi dhe rezultatet

Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë:

1. Raport Fillestar;
2. Raport të Analizës së Situatës Aktuale;
3. Draft Studim Fizibiliteti;
4. Draft Plan Biznesi të detajuar;
5. Raport Përfundimtar;
6. Hartëzim territorial (kur është e aplikueshme).

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe, në format elektronik dhe të printuar.

7. Afati i realizimit

Afati i realizimit të kontratës/shërbimit është 120 (njëqind e njëzet) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.

8. Metodologjia

Operatori Ekonomik duhet të propozojë një metodologji që përfshin:

- Mbledhjen e të dhënave në terren;
 - Intervista dhe konsultime me aktorët;
 - Analiza statistikore, ekonomike dhe financiare;
 - Përdorimin e standardeve të Bashkimit European dhe praktikave ndërkombëtare;
 - Përdorimin e analizës territoriale dhe hartëzimit dixhital (GIS), kur është e nevojshme.
-

9. Kërkesat specifike për stafin

Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht:

• 1 Drejtues Projekti

Diplomë Bachelor/Master në Ekonomi, Bujqësi, Blegtori ose fusha të ngjashme.

• 1 Specialist Veteriner/Zooteknik

Diplomë Bachelor/Master në Mjekësi Veterinare ose Zootekni.

• 1 Specialist Finance

Diplomë Bachelor/Master në Financë, Ekonomi, Menaxhim Biznesi ose fusha të ngjashme.

• 1 Specialist Agrobiznesi ose Teknologjie Ushqimore

Diplomë Bachelor/Master në Agronomi, Teknologji Ushqimore, Bioteknologji Ushqimore ose Shkenca Bujqësore.

• **1 Specialist për analizë territoriale ose zhvillim rural**

Diplomë Bachelor/Master në Arkitekturë, Planifikim Urban ose Inxhinieri Ndërtimi.

11. Menaxhimi dhe monitorimi

Zbatimi i kontratës do të monitorohet nëpërmjet grupit të monitorimit që do të ngrihet nga strukturat përgjegjëse në DZHE/DPPSIHZHE.

12. Dispozita të fundit

Ky dokument është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe shërben si bazë për zhvillimin e procedurës përkatëse.

13. Termat e pagesës

Pagesa për realizimin e shërbimit do të kryhet me këste, në varësi të dorëzimit dhe miratimit të produkteve përkatëse nga Autoriteti Kontraktor.

Struktura e pagesës propozohet si më poshtë:

- 20% e vlerës së kontratës – pas dorëzimit dhe miratimit të Raportit Fillestar;
- 25% e vlerës së kontratës – pas dorëzimit dhe miratimit të Raportit të Analizës së Situatës Aktuale;
- 25% e vlerës së kontratës – pas dorëzimit të Draft Studimit të Fizibilitetit dhe Draft Planit të Biznesit;
- 30% e vlerës së kontratës – pas dorëzimit dhe miratimit të Raportit Përfundimtar dhe prezantimit final.

Pagesat do të kryhen brenda afateve të përcaktuara në kontratë, pas konfirmimit me procesverbal të pranimit nga grupi i monitorimit në DZHE/DPPSIHZHE.

Në rast të mangësive në cilësinë e produkteve, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë rishikime përpara miratimit përfundimtar.

14. Grafiku i dorëzimeve (Deliverables & Afatet)

Afati total i kontratës: 120 ditë kalendarike

Nr.	Produkti / Deliverable	Përshkrimi	Afati nga nënshkrimi i kontratës
1.	Raporti Fillestar	Metodologjia, plani i punës dhe kalendari i detajuar	Brenda 15 ditëve
2.	Raporti i Situatës Aktuale	Analiza në terren, të dhëna statistikore dhe gjetjet kryesore	Brenda 30 ditëve
3.	Draft Studimi i Fizibilitetit	Analiza teknike, ekonomike dhe financiare	Brenda 30 ditëve
4.	Draft Plani i Biznesit	Modeli financiar dhe skenarët e zhvillimit	Brenda 35 ditëve
5.	Raporti Përfundimtar	Dokument i integruar me të gjitha rekomandimet	Brenda 110 ditëve
6.	Rishikimi dhe miratimi final	Reflektimi i komenteve dhe miratimi përfundimtar nga grupi i punës	Total 120 ditë

15. Mekanizmi i rishikimit dhe miratimit

- Çdo raport i dorëzuar do të shqyrtohet nga grupi i punës brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e dorëzimit;
- Komentet dhe sugjerimet do t'i komunikohen Operatorit Ekonomik për reflektim;
- Operatori Ekonomik është i detyruar të dorëzojë versionin e rishikuar brenda një afati të arsyeshëm (zakonisht 5 ditë pune);
- Miratimi përfundimtar do të bëhet vetëm pasi dokumentet të jenë në përputhje me kërkesat e këtyre Termave të Referencës.